



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**U R D H Ë R
Nr. 202 Datë 08. 07. 2004**

**PËR
MARRËDHËNIET MIDIS DREJTUESVE TË PROKUROKISË PËR
KRIME TË RËNDA DHE PROKURORËVE TË KOMANDUAR PRANË
SAJ PËR FËRFAQËSIMIN E AKUZËS NË GJYQ NË DISA ÇËSHTJE
TË VEÇANTA.**

Me urdhëra të veçantë të Prokurorit të Përgjithshëm, pranë Prokurorisë për Kxime të Rënda janë komanduar "prokurorë* të Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor, me qëllim përfaqësimin e akuzës në gjykimin e çështjeve penale, hetimi i të cilave kishte përfunduar pranë këtyre Prokurorisë.

Duke qenë se gjatë kësaj periudhe është vënë re,

- një mungesë totale e kontakteve, koordinimit dhe analizës së çështjeve, midis këtyre prokurorëve (kryesisht prokurorë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë) me Drejtuesit e Prokurorisë për Krime të Rënda;
- mospjesëmarrje e rregullt e tyre në gjykim ;
- mosvënie në dijeni të Drejtuesve të Prokurorisë për Krime të Rënda mbi vendimin e- Gjykatës, me qëllim për t'u ushtruar prej tyre e drejta e apelit në ato raste kur e shohin të arsyeshme;
- administrim jo korrekt i fashikullit të prokurorit mbas përfundimit të gjykimit në shkallë të parë ;

Me synim,

per të siguruar zhvillimin normal të gjykimit të këtyre çështjeve rritjen e cilësise së gjykimit të tyre;

shmangjen e problemeve te ndryshme administrative lidhur me arshivimin e fashikullit te prokurorit;

Në mbështetje, të nenit 8 pika 2 e vijues te Ligjit Nr.8737 datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë",

U R D H Ë R O J ;

1. Prokurorët e komanduar pranë Prokurorisë për Krime të Rënda, duhet të raportojnë menjëherë pranë Drejtuesve të kësaj Prokurorie për ecurinë dhe problemet e dala në çdo seancë gjyqësore të zhvilluar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në gjykimin e çështjes penale ku ata përfaqësojnë akuzën. Këtu përfshihet dhe diskutimi paraprak përpara dhënies së konkluzioneve përfundimtare.
2. Menjëherë mbas dhënies së vendimit nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duhet të vënë në dijeni Drejtuesit e Prokurorisë për Krime të Rënda me këtë vendim, me qëllim që këta të fundit të ushtrojnë të drejtën e apelit sipas nenit 408 pika 1 të K.Pr.Penale.
3. Mbas përfundimit te gjykimit, fashikulli i prokurorit bashkë me kartelën përkatëse duhet të dorëzohet sipas rregullave në sekretarinë e Prokurorisë për Krime të Rënda, ku do të arshivohet.
4. Për të gjitha çështjet që kanë përfunduar së gjykuari në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda përpara daljes së këtij urdhëri, nga prokurorët e çështjeve të merren masa për dorezimin e fashikullit të prokurorit ne sekretarinë e Prokurorisë për Krime të Rënda.
5. Mospërmbushja e detyrave të përcaktuara në këte urdhër, përbën shkelje të disiplinës në punë, neni 32 gërma "b", e Ligjit Nr.8737 datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.
6. Me këtë urdhër të njihen prokurorët dhe drejtuesit Prokurorive të të gjithë niveleve.
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PERGJITHSHEM

THEODHORI SOLLAKU

ANEKSI NR.1

1.Testimi për njohuritë teorike që oficerët e policisë gjyqësore duhet të kenë për legjislacionin, përfshijnë njohuritë për:

- 1.1. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë,
- 1.2. Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak,
- 1.3. Kodin e Procedurës Penale,
- 1.4. ligjin "Për ekzekutimin e vendimeve penale",

15. ligjin "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim",
16. ligjin "Për parandalimin e pastrimit të parave"
17. ligjin "Per mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë,
18. ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore",
19. Hgjin "Për policinë e shtetit,"
- 1.10. ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në R. Sh",
- 1.11. ligjin "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në R. Sh",
- 1.12. ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krime të Rënda",
- 1.13. ligjin Tër profesionin e avokatit në" R. Sh"
- 1.14. ligjin "Për autopsinë",
- 1.15. ligjet "Kodi i Etikës së Policisë" dhe "Për rregullat e etikës në administratën publike" ligjin "Për të drejtën e informimit për dokumentet Zyrtare", ligjin "Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike dhe psikotrope", si dhe
- 1.16. ligje të' tjera që lidhen me veprimtarinë procedurale penale të tyre.
- 1.17. vendimin e Këshillit të Ministrave "Për krijimin e institutit të Mjekësisë Ligjore",
- 1.18. vendimin e Këshillit të Ministrave "Për krijimin e institutit të Policisë Shkencore",

2. Testimi për njohuritë teorike që oficerët e policisë gjyqësore duhet të kenë për aktet ndërkombëtare të ratifikuara/aderuara në fushën penale dhe procedurale, përfshijnë njohuritë për:

- 2.1. Konventën Europiane "Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore" dhe Protokollat e saj, ratifikuar me ligjin Nr. 8137 datë 31. 07. 1996, FZ Nr.20, viti 1996, fq. 724;
- 2.2. Konventën Europiane "Për parandalimin e torturës dhe të trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor dhe degradues", aderuar me ligjin Nr. 8135, datë 31. 07. 1996, FZ, Nr.20, viti 1996, fq. 723;
- 2.3. Konventën e Kombeve të Bashkuara "Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar" dhe dy Protokollat shtesë të saj, ratifikuar me ligjin Nr. 8920 datë 11. 07. 2002, FZ Nr. 41', viti 2002, fq. 1195;
- 2.4. Konventën e Kombeve të Bashkuara "Kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope", aderuar me ligjin Nr. 8722 datë 26. 12. 2000, FZ. Nr. 50 viti 2000, fq. 2156;

- 2.5. Konventën e Kombeve të Bashkuara "Për substancat psikotrope", aderuar me ligjin Nr. 8965, datë 7. 11. 2002, FZ, Nr.79, viti 2002, fq. 2254;
- 2.6. Konventën Penale "Për korrupsionin", ratifikuar me ligjin Nr. 8778 datë 26. 04. 2001, FZ. Nr. 24 viti 2001, fq. 742;
- 2.7. Konventën e Kombeve të Bashkuara "Për luftën kundër financimit të terrorizmit", ratifikuar me ligjin Nr. 8865 datë 14. 03. 2002, FZ. Nr. 7 viti 2002, fq. 170;
- 2.8. Konventën Europiane "Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit", ratifikuar me ligjin Nr. 8646 datë 20.07.2000, F_Z Nr.23, viti 2000 fq. 1183.
- 2.9. Konventën e Këshillit të Europës "Për ekstradimin" dhe dy Protokollet shtesë të saj, ratifikuar me ligjin Nr. 8322 datë 2, 04. 1998, FZ. Nr.10, viti 1998, fq. 353;
- 2.10. Konventën e Këshillit të Europës "Për transferimin e procedimeve penale", ratifikuar 8497 datë 10. 06. 1999, FZ. Nr. 21, viti 1999, fq. 681;
- 2.11. Konventën e Këshillit të Europës "Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale" dhe Protokollin e dytë shtesë të saj, ratifikuar me ligjin Nr. 8498 datë 10. 06. 1999, FZ. Nr.21 viti 1999, fq. 697;
- 2.12. Konventën e Këshillit të Europës "Për transferimin e personave të dënuar", ratifikuar me ligjin Nr. 8499 datë 10. 06. 1999, FZ. Nr.22 viti 1999, fq. 719;
- 2.13. Konventën Europiane "Për mbikëqyrjen e personave të dënuar dhe të liruar me kusht", ratifikuar me ligjin Nr. 8724 datë 26. 12. 2000, FZ. Nr. 50 viti 2000, fq. 2234;

3. **Testimi për njohuritë teorike që oficerët e policisë gjyqësore duhet të kenë për praktikën gjyqësore, përfshijnë njohuritë për:**

- 3.1. vendimet e Gjykatës Kushtetuese në fushën penale dhe procedurale penale,
- 3.2. vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në fushën penale dhe procedurale penale.

ANEKSI NR.2

**Treguesit e Volumit, Cilesise dhe Shpejtesise per Of.Pol.Gjyqesore_
Prokuroria rrethit gjyqesor**

				Periudha		
				Vitet 2003	9-mujori 2004	
Ndjekja penale ne hetimet paraprake	Veprimet hetimore, zgjidhjet e rekomanduara dhe Perfundimi	Veprime hetimore	Referime	Ngjarje		
				Kallzime		
				Arrestime ne flagrance		
				Ndalime		
			Hetuar	Procodime		
				Te pandehur		
		Te arrestuar				
		Zgjatje Afati	Per procedimet ne hetim			
			Per te paraburgosurit ne hetim			
		Rekomandime pushimi	Procedime	Gjithsejt		
				Munges fakti		
				Munges provash		
				Shkaqe te tjera		
			Te Pandehur	Gjithsejt		
				Munges fakti		
				Munges provash		i
				Shkaqe te tjera		
		Mosoranuar/ndrvshuar				
		Rekomandime Pezullimi	Gjithsejt			
			Autori nuk dihet			
	1 pandehuri semure					
	Mospranuar/ndryshuar					
	Rekomandime Gjyqit	Procedime				
		Te pandehur				
		Te arrestuar				
		Mospranuar/ndryshuar				
	Te pandehur	Te arrestuar	Pushuar/ndryshuar akuza			
			Revokuar/ndryshuar m.sigurimit			
			Pafajesi e plote			
			Pafajesi e pjesesme			
		Te lire	Pushuar/ndryshuar akuza			
			Pafajesi e plote			
			Pafajesi e pjesesme			
	Procedime	ShfuqizuarV. pushimit/pezullimit				
		Kthyer aktet nga gjykata				
		Pushuar ceshtja ne gjykat				
		Pafajesi				
	Akte	Absolutisht te pavlefshme				
		Relativisht te pavlefshme				
Urdhera/vendime per anollimin e tyre						
Urdhra Eekutimi te Zbatuara						

Drejtuesi i Prokurorise

Oficeri P.Gjyqesore